



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**AUTORITETI I KONKURENCËS**  
**-KOMISIONI I KONKURENCËS-**

---

**VENDIM**  
**nr.396, datë 26.01.2016**

**“Për**  
**disa rekomandime mbi draft-kontratën koncesionare partneriteti publik privat e formës**  
**ROT “Për rehabilitimin, operimin dhe transferimin e infrastrukturës hekurudhore**  
**Fier-Ballsh, Fier - Vlore”**

Komisioni i Konkurrencës, me përbërjen e:

• Lindita MILO (LATI)	Kryetar
• Servete GRUDA	Zv.kryetar
• Koço BROKA	Anëtar
• Iva ZAJMI	Anëtar
• Eduart YPI	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 26.01.2016, shqyrtoi çështjen me:

**Objekt:** Vlerësimi ligjor i Draft-Kontratës Koncesionare “Partneriteti publik privat e formës ROT për rehabilitimin, operimin dhe transferimin e infrastrukturës hekurudhore Fier-Ballsh, Fier – Vlore”

**Baza ligjore:** Ligji nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës” (i ndryshuar), nenet: 2; 24, (shkronja f); si dhe ato 69 dhe 70, (pika 2).

Komisioni i Konkurrencës pas shqyrtimit të relacionit të vlerësimit ligjor të Sekretariatit lidhur me draft kontratën koncesionare “Partneriteti Publik Privat e formës ROT (rehabilitim, shfrytëzim dhe transferim) për rehabilitimin, operimin dhe transferimin e infrastrukturës hekurudhore Fier-Ballsh, Fier – Vlore”, si dhe relacionin shoqërues të Sekretarit të Përgjithshëm,

**VËREN SE:**

1. Pranë Autoritetit të Konkurrencës është depozituar shkesa me nr. 6417, datë 24.12.2015, dërguar nga Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës, ku kërkohet mendimi i Autoritetit të Konkurrencës në lidhje me draft kontratën koncesionare "Kontratë

Koncesioni/Partneriteti Publik Privat e formës ROT rehabilitim, operim dhe transferim per rehabilitimin, operimin dhe transferimin e infrastrukturës hekurudhore Fier-Ballsh, Fier – Vlorë”.

2. Në zbatim të Ligjit nr.125/2013 "Per koncesionet dhe partneriteti publik privat", (te ndryshuar), të akteve nënligjore në fuqi, Ministria e Transportit dhe Infrastruktures, me statusin e “*autoritetit kontraktues*” në datën 2 /06/ 2015 ka publikuar dokumentet standarde të procedurës përzgjedhëse konkurruese "Për dhënien me koncesion të formës ROT për rehabilitimin, shfrytëzim dhe transferimin e rrjetit të transportit hekurudhor ne linjat Fier - Ballsh dhe Fier - Vlorë" dhe ka ftuar operatorët ekonomikë të paraqesin ofertat e tyre.
3. Autoriteti Kontraktues shprehet se ka pranuar ofertën e paraqitur nga bashkimi i operatorëve ekonomik të shoqërive "Albstar" sh.p.k dhe "Matriks Konstruksion" sh.p.k, duke qenë se ky bashkim plotësonte kriteret dhe kushtet e vendosura për këtë koncesion.
4. Objekti i koncesionit është infrastruktura hekurudhore Fier - Ballsh, Fier – Vlorë, duke përcaktuar edhe tërësinë e shërbimeve, detyrimeve që lidhen me ekzekutimin, mbikëqyrjen dhe administrimin e kontratës, ndërkohë që forma e kontratës së koncesionit është "Rehabilitim, Operim dhe Transferim" në pronësi të shtetit (Rehabilitate-Operate-Transfer/ROT).
5. Autoriteti Kontraktues i jep Shoqërisë Koncesionare me koncesion të formës ROT (rehabilitim, operim dhe transferim) të drejta të vetme gjatë periudhës së koncesionit për realizimin e projektit në zonën e koncesionit dhe, në veçanti, të drejta për të rehabilituar infrastrukturën hekurudhore, operuar si administrues infrastrukture dhe transportues hekurudhor i integruar, vendosjen në funksionim dhe mirëmbajtur godina, infrastrukturën dhe shërbimet publike të infrastrukturës hekurudhore Fier - Ballsh dhe Fier – Vlorë dhe të gjitha ambientet e tjera të përcaktuara në zonën e koncesionit si dhe për mbledhur pagesat e përdoruesve të tretë te hekurudhës gjate periudhës se koncesionit.
6. Pika 5.2 “Detyrimet e përgjithshme të Autoritetit Kontraktor”, germa o, nuk sqaron rastet e detyrimit të subvencionimit të shërbimit publik, të cilat duhet të jenë në përputhje me Ligjin nr.9374, datë 21.04.2005 “Për Ndihmën Shtetërore”;
7. Periudha e përcaktuar e koncesionit është 25 vite kalendarike.
8. Ndërmarrja koncesionare do t’i paguajë çdo vit “Autoritetit Kontraktues” një tarifë fikse në masën prej 2,2 % të te ardhurave bruto.
9. Shoqëria Koncesionare, sipas pikës 15 të p/ kontratës, ka të drejtë të vendosë vetë tarifatat për çdo lloj shërbimi për hekurudhën, përveç se ato të parashikuar ne “Metodologjinë e përlllogaritjes së tarifave të përdoruesve të tretë të hekurudhës”. Shoqëria Koncesionare ka te drejtë të vendosë tarifatat e transportuesve të tjerë të hekurudhës gjate periudhës se koncesionit sipas metodologjisë to përcaktuar në Shtojcën 3 (Metodologjia e përlllogaritjes së tarifave të transportuesve të tjerë to hekurudhës). Shoqëria Koncesionare

ka të drejtën të propozojë rishikimin e tarifave të transportuesve të tjerë të hekurudhës çdo 4 (katër) vjet gjate periudhës se koncesionit.

10. Bashkëlidhur p/kontratës gjendet gjithashtu edhe Studimi i Fizibilitetit i kryer nga ofruesi i shërbimit, i cili përcakton se çfarë do të realizohet për të rikthyer në funksionale linjën hekurudhore Fier-Vlorë, si dhe linjën hekurudhore Fier-Ballsh, si dhe veprimet që do të ndërmerren për ta kthyer linjën hekurudhore në gjendje për të siguruar një lëvizje të pandërprere dhe të sigurve të mjeteve hekurudhore me shpejtësi deri në 50 km/ore për trenat e mallrave dhe 60 km/ore për trenat e pasagjereve.
11. Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës në respektim të dispozitave të Ligjit nr 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës” ( i ndryshuar), neni 69, ka sjellë për mendim pranë Autoritetit të Konkurrencës këtë draft kontratë koncensionare, i cili bazuar në këtë nen, germa b); ka për qëllim që të vendosë një të drejtë të vetme/ ekskluzive për ndërmarrjen në territorin në të cilin jepet ky koncesion dhe konkretisht për linjat hekurudhore Fier-Ballsh dhe Fier-Vlorë.
12. Periudha kohore e këtij ekskluziviteti është 25 vjeçare, dhe si e tillë do të jetë pjesë e fushës së zbatimit të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”( i ndryshuar), neni 2, germa c) , e cila parashikon se ligji zbatohet për ndërmarrjet publike dhe ndërmarrjet të cilave iu janë dhënë nga shteti të drejta ekskluzive ose të veçanta.
13. Kjo projekt-kontratë koncensionare, parashikon vendosjen e një të drejte ekskluzive, që bazuar në nenin 8 të Ligjit nr.9121, ndërmarrja koncensionare do të zotërojë që nga momenti i dhënies së kësaj kontrate koncensionare, pozicion dominues në treg, dhe i vetmi në treg për ofrimin e këtij shërbimi, në këtë zonë gjeografike të caktuar, për transportin hekurudhor të pasagjerëve dhe mallrave.
14. Kjo draft kontratë bazohet në partneritetin publik – privat dhe mund të konsiderohet si një formë e liberalizimit të sektorit të shërbimit hekurudhor, i cili ka qënë pothuajse jashtë funksionimit.
15. Për sa më sipër, draft “ Kontrata Koncesioni/Partneriteti Publik Privat e formës ROT rehabilitim, operim dhe transferim për rehabilitimin, operimin dhe transferimin e infrastrukturës hekurudhore Fier-Ballsh, Fier-Vlore”, nuk bie në kundërshtim me dispozitat e Ligjit “Për mbrojtjen e konkurrencës”, por në zbatim të neneve 8 dhe 9 të Ligjit nr.9121, Autoriteti i Konkurrencës ka kompetencën për të monitoruar sjelljen e kësaj ndërmarrjeje në treg, për të parandaluar dhe identifikuar rastet e abuzimit potencial me pozitën dominuese në këtë treg monopol.

### **PËR KËTO ARSYE**

Komisioni i Konkurrencës, bazuar në nenin 24, germa (f), nenin 69, pika 1, neni 70, pika 2, dhe nenin 28 të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, (i ndryshuar).

## VENDOSI:

- I.** T’i rekomandojë Autoritetit Kontraktor, Ministrisë së Transportit dhe Infrastrukturës:
1. Në zbatim të pikës 15 të draft “Kontratës të Koncesioni/Partneriteti Publik Privat të formës ROT për rehabilitimin, operimin dhe transferimin e infrastrukturës hekurudhore Fier-Ballsh dhe Fier – Vlorë”, tarifat e miratuara nga Autoriteti Kontraktor të jenë të orientuara drejt kostos.
  2. Të saktësohet pika 5.2 “detyrimet e përgjithshme të Autoritetit Kontraktor”, gërma o, për rastet e detyrimit të subvencionit të shërbimit publik.
- II.** Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës duhet t’i drejtohet Autoritetit të Konkurrencës në rastet kur gjykon se vërehen shkelje të mundshme të Ligjit nr 9121, datë 28.07.2003 ‘Për mbrojtjen e konkurrencës’ (i ndryshuar) gjatë periudhës koncensionare;
- III.** Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi dhe përcjelljen shkresërisht të tij tek palët objekt-kontrate.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

## KOMISIONI I KONKURRENCËS

**Servete Gruda**

(\_\_\_\_\_)  
**Zv/Kryetar**

**Koço Broka**

(\_\_\_\_\_)  
**Anëtar**

**Iva Zajmi**

(\_\_\_\_\_)  
**Anëtar**

**Eduart Ypi**

(\_\_\_\_\_)  
**Anëtar**

**Lindita MILO(LATI)**

\_\_\_\_\_  
**K R Y E T A R**